

Raporti mbi realizimin e programit të investimeve në objektet shkollore dhe në pajisje në bazë të Ligjit mbi sigurimin e mjeteve për disa programe urgjente në Republikën e Sllovenisë në edukim dhe arsimim nga viti 1994-1999 (Ligji mbi “tollarin shkollor”)

Lubjanë. Qershor 2000

1. HYRJE

Në fillim të viteve të nëndëdhjetta në Republikën e Sllovenisë filloi dukshëm të shtohet interesi i të rinjëve për arsimim në krejt vertikale (shkolla të mesme, fakultete dhe shkolla të larta) e që shkaktoj në mes tjerash rritjen e pjesës së rregjistrimit të nxënësve me shkollë fillore të mbaruar në shkolla të mesme (Tabela 1) dhe rritja e numrit të studenteve në shkollat e larta dhe ato të nalta në të dy univerzitetet (Tabela 2). Gjithkrah filloi të rritet kalueshmëria nëpër vite.

Tabela 1: Pjesa e rregjistrimit të nxënësve që kanë mbaruar shkollën fillore në shkolla të mesme:

Viti shkollor	1991/92	1992/93	1993/94
% e të rregjistruarve	88,37	88,56	92,13

Tabela 2: Numri i studenteve në shkolla të nalta dhe të larta në të dy univerzitetet :

Viti shkollor	1991/92	1992/93	1993/94
Numri i studenteve	36.504	37.362	40.239

Rritjen ishte e mundur të presim edhe në vitet që vijojnë e që sot tregojn të dhënat empirike, ku numri i nxënësve të shkollës fillore pas kryerjes rregjistrohen në shkollë të mesme e që rritet në 99%, numri i studenteve në shkollat e larta dhe ato të nalta në të dy univerzitetet kap 50 % të gjeneratës.

2. GJËNDJA NË LËMIN E OBJEKTEVE SHKOLLORE DHE PAJISJEVE

Objektet shkollore ishin në nënyrë të madhe para pranimit të “ligjit mbi tollarin shkollor” jo adekuate. Shkaqet për at gjë ishin (në mes tjerave rritja e interesit të të rinjëve për edukim) :

- Ish ligji federativ nga viti 1981 ndalonte rreptësisht investimet në objekte të veprimtaris shoqërore e që shkaktoj ndërprerjen 10 vjeçare të investimeve në at lëmi ;
- Plakja e objekteve dhe ndërtimi jociësorë i objekteve shkollore në vitet e gjashtëdhjetta;
- Shumë shkolla ishin të ndërtuara pa salla të fiskulturës apo objekteve tjera sportive;
- Në të kaluarë ishin objektet keq të mirëmbajtur sepse ata që e kishin ndertua ato nuk i mirëmbanin më ato;
- Teknologjia mësimore çdo herë e më tepër ikërkonte perfeksionizëm para së gjithash në lëmin e informatikës lëmit tjera të pajisjeve pedagogjike.

Ministria për arsim dhe sport kishte ca mjete para pranimit të ligjit mbi “tollarin shkollor” për investime mirëpo ato mjete ishin shumë të vogla që të mbuloj t gjitha kerkesat dhe ti sanojnë të gjitha mangësit.

3. QËLLIMET E LIGJIT MBI TOLLARIN SHKOLLOR DHE LARTËSIA E MJETEVE TË PARAPARA

Ligji mbi sigurimin e mjeteve për disa programe urgjente zhvillimore në Republikën e Sllovenisë mbi edukim dhe arsimim u pranua në vitin 1994 dhe ishte i drejtuar për çështje zhvillimore. Siguronte mjete shtesë me të cilat ishte e mundur të ndërpritet mrbambetja shumevitëshe e investimeve në objektet shkollore.

Në mes qëllimeve të ligjit ishin të rënditura :

- Menjammimi i mësimin në dy turne në shkollat e mesme,
- Sigurimii i mjeteve gjegjëse për zhvillimin e edukatës sportive,
- Përmirsimi i kushteve për punë në univerzitet dhe në shkollat e larta profesionale,
- Sigurimi i kushteve gjegjëse për punë në institutet për rini me pengesa në zhvillim,
- Zgjedhja e problemeve hapsinore të shkollave në regjione demografike të rrezikuara dhe
- Zgjeddhja e problemeve hapsinore në shkollat e pakicave kombetare.

Dinamika e financimit dhe programi i investimeve ishte e prezentuar në Raportin e parlamentit të shtetit slloven. Nuk ishte i botuar si pjesë përbërëse e ligjit mirëpo ishte si bazë për vendosje në Parlamentin e Republikës se Sllovenisë. Lartësia e mjeteve për investime në Raportin ishte 17.716.000.000 SIT sipas çmimeve me datë 1.1.1994.

Ligji e përcaktonte mjetet e duhura për zhvillimin e të gjitha programeve nga ligji (investimet në objektet shkollore, përvetsimin kompjuterik, dija e gjuhëve të huaja sigurimi i kapshmerisë së librave mësimor dhe materialeve mësimore si dhe sigurimin e ushqimit të rinis) në lartësi 27.548.000.000 SIT sipas çmimeve me datë 1.1.1994 (apo përafersisht 360.626.422 DEM – sipas kursit të atëhershëm të Bankës Sllovene BS: 100 DEM = 7.638,93 SIT). Me ligj ishte i përcaktuar poashtu kuir i lartë apo i poshtëm për realizimin e programit në tërësi “tollari shkollor” nuk do të apërcente shumë prej 5 miliard SIT apo të jenë më e vogël se 4 miliard SIT sipas çmimeve me datë 1.1.1994. Me ligj ishte i përcaktuar poashtu, që » plani financiar vjetor për realizimin e programeve ... dhe dinamika e sigurimit të mjeteve ... e përcakton Qeveria e Republikës së Sllovenis «.

4. REALIZIMI I INVESTIMEVE PËR OBJEKTET SHKOLLORE NË VITIN 1994 - 1999

(sipas paragrafit të buxhetit në suaza të Ministris për arsim dhe sport)

Qeveria e Republikës së Sllovenisë i pranoj planet vjetore për realizimin e projektit investue në objektet shkollore për vitin 1994-1999. Si bazament i planeve financiare ishte programi investues në objektet shkollore e që ishte i botuar ne Raportin e Parlamentit të shtetit sllove, e përpos asaj Qeveria e Republikës së Sllovenis në planin financiar e kishte renditur edhe investime tjera urgjente në lëmin e shkollimit e të cilat në vitin 1994 nuk ishte e mundur të parashikonte e për to të përfitonte edhe mjete tjera shtesë siç janë të prezentuara në tabelën 3.

Tabela 3: dinamika finansuese për realizimin e investimeve në periudhën 1994-1999 (në mio. SIT)

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	Së bashku
--	------	------	------	------	------	------	-----------

Plani – tollari shkollor	2.985	2.985	2.975	3.009	2.793	2.969	17.716
Revalorizimi i planit të tollarit shkollor *	2.985	3.835	4.159	4.600	4.608	5.196	25.383
Realizimi i planit të tollarit shkollor	2.820	2.401	3.483	3.175	4.165	5.106	21.150
Mjetet investuese jasht tollarit shkollor	311	845	1.011	3.042	1.856	2.698	9.763
REALIZIMI SË BASHKU	3.131	3.246	4.494	6.217	6.021	7.804	30.913

* revalorizimi në çmimet rrjedhëse sa i përket asaj se ishin çmimet në “ Ligjin mbi tollarin shkollor” të përcaktuara sipas çmimeve të datës 1.1.1994.

Në vazhdim do të tregojm realizimin e investimeve të “tollarit shkollor” dhe projektet të cilat Qeveria e Republikës së Sllovenis i renditi në planet financiare vjetore në paragrafet në suaza të minsitris së arsimit dhe sportit.

4.1. Realizimi i investimeve në suaza të projektit të tollarit shkollor

Kriteriumet në bazë të cilave ishin të rënditura në plan ishin sa vijon:

- Obligimimet sipas ligjit,
- kreditet e marrura ,
- gjëndja ndërtimore e objekteve (siguria e banimit),
- rregjistrimi i nxënësve dhe studenteve (sigurimi i vendeve studentore),
- parapërgatitja e komunes, shkollës, univerzitetit apo shoqatave për investime (lokacioni +mjetet e veta),
- parapërgatitja profesionale e investimeve (pranimi i bazës profesionale, planet ideore, projektet),
- e tjera .

Nga 157 objekteve të parapara ishin realizuar 113 objekte apo 72% e tyre.

Objektet tjera nuk ishin realizuar për shkak të :

- ndryshimi i planeve investuese shkollore nëpër komuna aty ku komunat kishin prioritet tjera ndërtimore
- gradualitetit lidhur me kërkesat denacionalizuese,
- vështirësit në lidhje me përfitimin e dokumentacionit gjegjës dhe lokacioneve për ndertim,
- mos përgatitja e bashkësive lokale për bashkpunim para së gjithash në përfitimin e e lokacioneve gjegjëse për shkak të kërkesave të mëdha urbanistike dhe kontributeve komunale
- ndryshimi i nteresit të të rinjëve për edukim dhe arsimim (për shkak të rregjistrimit në programet shoqërore dhe zvoglimi i rregjistrimit në programet teknike natyrore si në shkollimin e mesëm ashtu dhe në atë të lartë)
- për shkak të prioriteteve tjera që ishin të përcaktuara me rastin e pranimit të Ligjit mbi marrjen e krediteve në Fondin e Bashkimit Evropian për zhvillim social dhe realizimin e projekteve të investimit në objektet shkollore dhe në pajisje në Republikën e Sllovenisë (ZNPSPO) e që e ka pranuar Kuvendi i Republikës së Sllovenis në vitin 1998.

Planet e përvjetshme financiare për realizimin e programeve të investimeve sipas atij ligji kishin bazë në parashikimin e problemeve të reja që paraqiteshin me rastin e rregjistrimit në shkollimin e mesëm dhe të lartë si dhe në ndryshimet e disa institucioneve dhe kushteve për përgatitjen e investimeve të posaçme. Disa investime ishin të plotësuara dhe të formuara, kurse askund nuk ishin të tejkaluara standardet valide ndërtimore dhe normative.

Shumica e investimeve të cilat për shkak të vështirësive nuk u renditen në planin financiar e të cilat i ka pranuar Qeveria Sllovene në suaza të “tollarit shkollor” ishte e kapshme në ZNPSPO, e që përcaktonin programet investues nga viti 1998 – 2002 .

4.2. Investimet në lëmin e shkollimit të cilat Qeveria Sllovene i renditi serish në planet financiare të investimeve

Qeveria e Republikës së Sllovenisë, i renditi serish në planet vjetore financiare disa investime në lëmin e shkollimit. Në tërësi bëhet fjalë për 47 investime e shkaqet ishin këto:

- Ndryshimet e planeve të investimeve shkollore në komuna ku janë vëndosur për prioritet tjera,
- Gjëndja e keqe fizike e objekteve të caktuara,
- Shtimi i paprapar i rregjistrimit në disa shkolla.

Në mes viteve 1994 dhe 1996 nuk ishte kërkesë për renditjen e investimeve shtesë e që kërkoheshin mjete financiare por ajo ngjau në vitet 1997 dhe 1998 për shkak të:

- Vëndimit të Qeverisë së Republikës Sllovene në vitin 1996 për blerjen e objektit të shtypshkronjes Ljudska pravica për nevojat e fakultetit juridik të Universitetit të Lubjanës për ç shkak ishte e realizuar pagesa nga mjetet e buxhetit në vitin 1997 dhe për shkak të
- Pranimit të Ligjit për rentimin e krediteve pran Fondit të Bashkimit Evropian për zhvillim social dhe realizim të projekteve investuese në objektet shkollore dhe pajisje në Republikën e Sllovenisë në vitin 1998 e që u vëndos renditje tjetër e investimeve në shkollim nga viti 1998 – 2002 .

5. PËRFUNDIM

Realizimi i projektit investues i cili rrjedh nga pranimi i ligjit mbi “tollarin shkollor” mund të vlersojmë si shumë të suksesëshëm. Shumë shkolla (në krejt vertikale) në atë bazë ligjore i fituan objektet gjegjëse shkollore. Ai ishte padyshim sukses i madh në më se dhjetë vite mos investime në objekte shkollore. Kryetarve të komunave dhe puntorve udhëheqës në arsimim dhe edukim me ato masa në investime shkollore u bënë të kapshme dhe reale. Edh pse kishte shumë objekte shkollore të modernizuara në anën tjetër u bë shtypje e madhe në Qeverinë e Republikës Sllovene , të siguroj mjete për at qëllim. Për at shkak Qeveria sllovene i propozoj Kuvendit të shtetit slloven pranimin e Ligjit mbi kreditim pran Fondit të Bashkimit Evropian për zhvillim social dhe realizim të projekteve investuese në objektet shkollore dhe pajisje në Republiken e Sllovenisë, e cila investimeve shkollore u siguroj mjete shtesë. Për shkak të mundësive të kufizuara të buxhetit të Republikës Sllovene dinamika e mjeteve e cila ishte papraparë sipas ZNPSPO në buxhetin vijues stagnoj. Për at shkak programi i investimeve nga ai ligj u zgjat për 3 ose 4 vite e me at lindën edhe nevojat tjera.

Ishte me se e qartë se duhej siguar mjete për investime shkollore edhe pas viti 2002 kur skadon ZNPSPO në shkallën e viteve të mëparshme. Nevojat për investime shkollore sa i

përket gjendjes së objekteve në të cilat funksionojn edhe sot shkollat do të jen aktuale edhe nje kohë të caktuar. Me probleme me të mëdha numrojm :

- Zsigurimin e objekteve gjegjëse dhe hapsirave për edukim parashkollor (futja e nendëvjeçares) në konkursin e parë për ato investime janë paraqitur 159 komuna me më se 600 objekte;
- Sanimet kunder terrmeti dhe statike ne disa shkolla , konvikte studentore dhe fakultete (para së gjithash në Lubjanë);
- Sigurimi i shtretneve studentor ; në Slloveni mungojnë afro 5000 vende për student;
- Zgjedhja e problematikës se disa fakulteteve që veprojn në kushte joadekuate;
- Zgjedhja e rrjetave të shkollave të mesme në disa qytete të mëdha (Maribor, Kranj, Nova Gorica).

Para së gjithash duhet krahas me këtë të rriten mjetet për mirëmbajte të objekteve. Në të kundërtën do të paraqiten kërkesa për investime edhe në objekte që janë në ditë të sotme në gjëndje teknike relativisht të mirë.

Perkthyer nga: Martin Berishaj
Perkthimi u mundesua nga SEE ECN